

STATUTI DHE AKT THEMELIMI

I SHOQËRISË ME PËRGJËGJËSI TË KUFIZUAR "GRAND VIEW SPILLE" SH.P.K.

Sot, më 01 /12 2023 ne ortakët: 1 Z. SKENDER BIBA i biri i HEKURAN lindur në KRYEVIDH më 03.01.1973 dhe banues në ZHABJAK RROGOZHINE shtetas Shqiptar mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036610897 dhe numër personal H301030040K madhor dhe me zotësi juridike për të vepruar;

I cili me vullnetin e tij të lirë dhe të plotë në cilësinë e ortakut të shoqërisë në krijim e sipër bazuar në legjislacionin shqiptar në fuqi hartojnë akt themelin dhe këtë statut të shoqërisë tregtare GRAND VIEW SPILLE e cila ka formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (shpk), e cila do te funksionoje në përputhje me ligjin Shqiptar dhe në përputhje me këtë statut.

BAZA LIGJORE

- “Kushtetuta e Republikës se Shqipërisë”;
- “Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- “Ligji Nr. 9723 dt. 03/05/2007 “Për Qëndren Kombëtare te Rregjistrimit”;
- “Kodi Civil i Republikës se Shqipërisë”;

STATUTI

DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1: Emërtimi i Shoqërisë

Ka vendosur krijimin e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar me emrin "GRAND VIEW SPILLE" SH.P.K. me poshtë e quajtur edhe Shoqëria. Emri i shoqërisë mund të ndryshohet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 2 Forma e Shoqërisë

Shoqëria tregtare "GRAND VIEW SPILLE" SH.P.K" është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar .

Neni 3: Selia e Shoqerise

3.1 Selia e shoqërisë "GRAND VIEW SPILLE" SH.P.K. është: HARIZAJ KAVAJE ZONA KADASTRALE 1932.

Skender Biba


Ndryshimi i selisë së shoqërisë mund të bëhet vetëm me vendim të asamblesë së përgjithshme.

Neni 4: Objekti i aktivitetit:

Investime, pjesmarrje në fushën industriale turistike, në fushën agroturizëm, duke përfshirë të gjitha operacionet komerciale, ndërtimore, industriale së bashku me shërbimet përkatëse që konsistonjë në investimin, sipërmarrjen, realizimin, blerjen, shëndërrimin, kompensimin, importimin, eksportimin, ruajtjen, ndërtimin, restaurimin, montimin e produkteve, materialeve, shërbimeve përkatëse specifike në konceptimin, krijimin, realizimin dhe zhvillimin e aktivitetit hotelier-turistik, tregtimin e mallrave të ndryshme me shumicë dhe pakicë, veprimtari në fushën e shit-blerjes si dhe të gjithë formave të qirasë apo të shfrytezimit të pasurive te patundshme. Veprimtari në fushën e strukturave akomoduese hoteleri, bar restorant, me plan shërbim të personalizuar dhe plan shërbim " cdo gjë e përfshirë" (all inclusive), shazllone, stacione plazhi, lundrime turistike, sporte ujore, pistë ne det me lokacion bar restorant, vendbazim për mjete ujore, motorrike dhe jo motorrike, transport organizim i tureve guidave të ndryshme turistike, zhvillimi i panaireve, seminareve dhe workshopave, shërbime opsionale plotësuese me karakter elodhje, pushimi, apo dëfrimi, spektakli, lojëra, organizime dhe realizime "event-sh" të ndryshme, shërbimi spa, shërbim parkimi, si dhe çdo veprimtari tjeter ekonomike që do të konsiderohet e nevojshme dhe e dobishme për vijimin e aktivitetit të shoqërisë.

Neni 5: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë "GRAND VIEW SPILLE" SH.P.K.do të jetë për një periudhë të pacaktuar duke filluar nga moment i rregjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit,

Neni 6

Filiale dhe zyrat e perfaqësisë

Shoqëria Tegtare "GRANDVIEW SPILLE" SH.P.K. mund të ketë filial ose zyra përfaqësie në territorin Shqiptar ose të huaj nëse do të vendosë asamblea e ortakëve.

KREU III

NENI 7 Kapitali themeltar i shoqërisë

7.1 Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100 (nje qind) lekë.

7.2 Kapitali themeltar i Shoqërisë përbëhet nga 1 kuote të gjitha të nënshkruara dhe firmosura

Shermola Biku


NENI 8 Kontributet

Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

8.1. Z. Skender biba zoteron një kuotë e cila korrespondon me 100 % të kapitalit të shoqërisë me vlerë 100 (njeqinde) lekë;

NENI 9

Zmadhimi i kapitalit

9.1. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet pa limit një ose më shumë herë me anë të vendimit të asamblesë së ortakëve;

NENI 10

Zvogëlimi i kapitalit të shoqërisë

10.1 Shoqëria mund të zvogëlojë kapitalin e saj me vendim të asamblesë së ortakëve. Në cdo rast, kapitali i regjistruar i shoqërisë nuk mund të ulet nën limitin dysheme të vendosur me ligj;


NENI 11

Transferimi i kapitalit

11.1 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht;

11.2 Kuotat e kapitalit të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të kalohen të tjerëve plotësisht ose pjesërisht personave të tretë jashtë kësaj shoqërie, por duke respektuar këto klauzola:

- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes për kuotat që dëshiron të trasferojë/kaloj
- Ortakët kanë të drejtën e parablerjes së kuotave me të njëjtat kushte dhe të njëtin çmim me të cilin ortaku mund të ja shiste një personi të tretë kuotën e tij. Brenda 10 (dhjetë) ditëve nga momenti i komunikimit për shitjen ortakët duhet të ushtrojnë të drejtën e tyre të parablerjes, në rast të kundërt do të konsiderohet se kanë hequr dorë nga kuota;
- Në rast se ortaku që dëshiron të shesë kuotën e tij, ja kalon një personi të jashtën nga shoqëria me kushte më të favorshme në krahasim me ato të ofruara ortakëve në lidhje me të drejtën e parablerjes nga ana e tyre, atëherë kontrata për kalimin e kuotave që do të nënshkruar me personin e tretë nuk do të jetë i vlefshëm dhe shoqëria dhe ortakët nuk do



të jepin miratimin për këtë kalim duke u bërë shkak në këtë mënyrë për pavlefshmëri të kontratës së shitjes së kuotave të kapitalit.

11.3 Të gjitha komunikimet midis ortakëve do të bëhem me shkrim dhe me postë rekomande me lajmërimim marje.

KREU JV

ORGANET VENDIMMARESE DHE DRE-JTUESE

NENI 12 Organi Vendimmarres

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimtarës i shqëritës.

NENI 13

TÉ DREITAT DHE DETYRIMET E ASAMBLESË

Asambleja e Ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë në lidhje me çështjet e mëposhtme:

- a) përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) ndryshimet e statutit;
 - c) emërimin e shkarkimin e administratorëve;
 - ç) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - d) përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" dhe "ç" të kësaj pike;
 - dh) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
 - ë) zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;
 - f) pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
 - g) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - gj) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
 - h) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
 - i) largimin dhe perjashtimin e ortakeve;

Stenodice Bilea

3

j) Marrjen kredi apo hipotekimin e aseteve te shoqërisë.

k) çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.

NENI 14

MBLEDHJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME

14.1 Asambleja e përgjithshme thirret në rastet e parashikuar nga ligji ose në statut, sa herë do të konsiderohet e nevojshëm për mbrojtjen e interesave të shoqërisë

14.2 Asamblea duhet të thërritet të paktën një herë në vit;

14.3. Asamblea e përgjithshme thirret sipas parashikimeve të nenit 83 dhe 84 të ligjit nr. 9901, datë 14.01.2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare";

14.4. Ortakët do të njoftohen nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statuti, me njoftim nëpërmjet postës elektronike.

14.5. Njoftimi me shkresë apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas këtyre rregullave dhe sipas këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë;

14.6. Mbledhja e përgjithshme e asamblesë mund të mbahet në selinë qendrore të shoqërisë ose në një vend tjetër të përcaktuar.

NENI 15

Pjesëmarrja në vendime

15.1 Ortakët kanë të drejtën e votës në proporcion me pjesëmarrjen e tyre në kapitalin social;

15.2. Ortakët mund të përfaqësohen në asamble nga një person i tretë në bazë të një autorizimi. Ky autorizim mund të lëshohet për një mbledhje të vetme ose mbi më shumë mbledhje.

NENI 16

PROCESVERBALI I MBLEDHJES

16.1 Të gjitha vendimet e mbledhjes do të regjistrohen në procesverbal. Prosesverbal duhet të përcaktojë datën, vendin e mbledhjes, rendin e ditës, emrin e presidentit të mbledhjes, emrin e sekretarit të mbledhjes dhe rezultatin e votimit;

Shenova Bila


16. 2 Presidenti i mbledhjes përcakton kush do të jetë sekretari për redaktimin e procesverbalit i cili mund të mos jetë ortak. Prosesverbalit duhet të nënshkruhet nga presidenti dhe nga sekretari.

16. 3 Prosesverbalit i bashkëlidhet emrat e personave prezent dhe njoftimi për thërritjen e mbledhjes së asamblesë së përgjithshme.

NENI 17

Administratori

17.1 Administratori është organi ekzekutiv i shoqërisë

17.2 Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emërimit, është 5 vjet, me të drejtë ripërtëritjeje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit. Administratori ka të drejtën e administrimit të zakonshëm të shoqërisë.

17. 3. Ka të drejtë kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme;

17. 4 Ka të drejtë të përfaqësojë shoqërinë tregtare përpara cdo institucioni publik ose privat;


17. 5 Ka të drejtë të përgatisë cdo lloj akti të nevojshëm për ecurinë e shoqërisë dhe ta depozitojë pranë cdo institucioni publik ose privat sipas ligjeve në fuqi;

17. 6 Merret me menaxhimin e përditshëm të shoqërisë duke kryer të gjitha aktivitete e nevojshme për menaxhimin dhe mbikqyrjen e personellit; kryen punësimet dhe pushimet nga puna; përcakton udhëzime për kryerjen e detyrave për aktivitetin e shoqërisë; mbani korrespondencën e shoqërisë; autorizon mblerjen, qiran e sendeve ose shërbimeve të nevojshme të lidhura direkt ose indirect me aktivitetin tregtar të shoqërisë; autorizon kryerjen e trasfertave bankare ose tërheqjen e shumave nga llogaritë rrjedhëse të shoqërisë në lidhje me pagesat e pagave ose shpërblimet e punonjësve të shoqërisë; firmos faturat për shërbimet dhe veprimet që shoqëria kryen; kryen të gjitha veprimet e nevojshme përsa i përket nënshkrimit të cdo pagesë bankare, depozitat, tërheqjet, derdhjet ose trasfertat të ndryshme në llogaritë e shoqërisë të të gjitha llogaritë e shoqërisë, pranë cdo banke në të cilën llogaritë janë hapur;

17. 7 Përfaqëson shoqërinë në lidhje me cdo kontratë ose marrëveshje me të tretët persona fizike ose juridike, vendas ose të huaj, me intitucionë ose ente publike të cfarë do lloji;

17. 8 Për administrimin e jashtëzakonshëm të shoqërisë që kalon tagrat e mësipërm administratori duhet paraprakisht të ketë marrë miratimin e asamblesë së përgjithshme.

17. 9 **Administrator te shoqërisë GRAND VIEW SPILLE shpk do të jetë Z. FABIO BIBA** i biri i SKENDER lindur në KAVAJE më 18.11.2000 dhe banues në ZHABJAK RROGOZHINE shtetas Shqiptare mbajtës i letërnjoftimit me nr. 033728845 dhe numër personal



K01118031T i cili do të administratojë aktivitetin e zakonshëm të shoqërisë, ndërsa përsa i përket admnistrimit të jashtëzakonshëm, hapjen e llogarive bankare, depozitat, marrja krediti ose hipotekim te pasurive të shoqërisë do të jetë e nevojshme gjithmonë vendim i asamblesë së ortakëve.

10. Administrator te shoqërisë GRAND VIEW SPILLE shpk do të jetë Z. ORGEST BIBA i biri i SKENDER lindur në KAVAJE më 09.11.2002 dhe banues në ZHABJAK RROGOZHINE shtetas Shqiptare mbajtës i letërnjoftimit me nr. 036621245 dhe numër personal K21109040Vi cili do të administratojë aktivitetin e zakonshëm të shoqërisë, ndërsa përsa i përket admnistrimit të jashtëzakonshëm, hapjen e llogarive bankare, depozitat, marrja krediti ose hipotekim te pasurive të shoqërisë do të jetë e nevojshme gjithmonë vendim i asamblesë së ortakëve.

KREU V

Eksperet kontabil, viti Financiar dhe Bilanci, Destinimi i të ardhurave

Neni 18

Viti Financiar dhe të ardhurat

18.1 Viti financiar i Shoqerise fillon me 1 Janar dhe perfundon me 31 Dhjetor. Perjashtimisht, viti i pare financiar fillon nga data e regjistrimit te shoqerise ne Qendren Kombetare te Regjistrimit dhe mbyllte me 31 Dhjetor të po atij viti.

18.2 Bilanci vjetor, inventari, raporti mbi ecurinë e aktivitetit tregtar dhe raporti i ekspertit kontabël të autorizuar aprovohen nga asamblea e përgjithshme.

18.3 Bilanci dhe pasqyrat financiare për vitin financiar duhet të aprovohen brenda 3 muajve nga përfundimi i vitit financiar

NENI 19

Shpërndarja e të ardhurave

Të ardhurat i shpërndahen ortakëve në proporcion me pjesëmarjen dhe kuotat e tyre

Shoqëria mund të shpërndajë të ardhurat vetëm nëse:

- Aktivet e shoqërisë mbulojnë plotësisht detyrimet e tyre;
- Shoqëria posedon aktive në likuiditet të mjaftueshme për të mbuluar detyrimet qe bëhen të kërkueshme brenda 12 muajve të ardhshëm.

Shenohi Bilanç **KREU VI**
S. S.

Prishja –riorganizimi i shoqërisë

NENI 20 Mbyllja dhe likuidimi

20.1 Shoqëria shpërndahet ose prishet në cdo kohë në rastet e parashikuar nga ligji ose asamblea e përgjithshme :

- a) kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelimin e saj;
- b) me vendim të Asamblese se Ortakeve;
- c) me hapjen e procedurave të falimentimit;
- ç) nëse nuk ka kryer veprimtari tregtare për dy vjet dhe nuk është njofuar pezullimi i veprimtarisë në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit nr.9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit";
- d) me vendim të gjykatës;

20. 2 Në këtë rast Ortaket marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar 1 apo disa likuidatore dhe shënuar në cdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emrës shtesë " Shoqëri në likuidim e sipër ".

20.3 Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

20.4 Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga Ortaket.

20. 5 Nëse Ortaket nuk merrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës, për të caktuar një likuidues.

KREU VII

DISPOZITA TË FUNDIT

NENI 21 Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarreveshje që mund të lindë midis Shoqerise dhe të tretëve, do të zgjidhen me marrëveshje në rast se nuk arrihet marrëveshja atëherë kompetente do të jetë Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

NENI 22

Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë



Ky statut dhe akt themelimi janë mbajtur në 4 kopje në gjuhë shqiptare.

ORTAKU I VETEM I SHOQERISE .

SKENDER BIBA

Skender Biba
